



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Nr. 131 Prot.

Tiranë, më 31.03. 2016

**Lënda:** Dërgohet për njohje dhe zbatim urdhri i Ministrit të Kulturës për shpalljen e objektit ku kryen aktivitetin e saj Akademia e Shkencave, monument kulture i Kategorisë së I-rë

**Drejtuar:** TRASHËGIMTARËVE TË Z. ZIJA TOPTANI

**Për dijeni:** Institutit të Monumenteve të Kulturës, IMK  
Ish-Kinostudioja  
Tiranë

Të nderuar zonja dhe zotërinj,


Ju bëjmë me dije se, me Urdhrin nr. 67, datë 17.03.2016, "Për shpallje monument kulture e kategorisë së I-rë për objektin Akademia e Shkencave, Tiranë", Ministri i Kulturës ka urdhëruar shpalljen monument kulture të kategorisë së I-rë, të objektit "Akademia e Shkencave", Tiranë.

Në zbatim të nenit 13, të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore", i ndryshuar, personat fizikë dhe juridikë, që kanë në pronësi objekte me vlera të trashëgimisë kulturore, të luajtshme e të paluajtshme, të regjistruara, janë të detyruar të krijojnë kushtet e nevojshme për mirëmbajtjen e këtyre objekteve. Gjithashtu neni 28 i ligjit të sipërcituar shprehimisht citon se: ".... monumente kulture të kategorisë I-rë janë ndërtimet me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre arkitektonike dhe teknike. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetricke dhe funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen."

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin, bashkëmbyllur Urdhëri në fjalë.

KRYETARI

MUZAFER KORKUTI



**URDHËR**

Nr. 67, Datë 17.03 2016

**PËR**

**SHPALLJE MONUMENT KULTURE E KATEGORISË SË I-RË PËR OBJEKTIN**  
**“AKADEMIA E SHKENCAVE”, TIRANË.**

Në vijim të kërkesës nr. 110 prot, datë 17.03.2016 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve konstatova se në mbledhjen e datës 11.03.2016 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve me Vendimin nr. 58, datë 11.03.2016, ka shqyrtuar dokumentacionin mbi propozimin e diskutuar në Këshillin Shkencor për shpallje monument kulture të kategorisë së I-rë të godinës së Akademisë së Shkencave, e cila aktualisht ka status monument kulture kategoria e II-të, diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

Nisur sa më sipër, në mbështetje të nenit 102, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 28 të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen monument kulture kategoria I-rë të objektit “Akademia e Shkencave”, Tiranë.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” për njoftimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

  
MINISTRI  
Mirela KUMBARO FURXHI